



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:064750

Datë: 30.01.2023

Numri i dokumentit: 03915703

A.nr.786/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit Sh.K., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me bazën juridike: anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 27.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.K., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve.

II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve i datës 14.01.2021 dhe çështja i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje organit të paditur.

A r s y e t i m i

Paditësi me padinë e datës 07.04..2021, ka kërkuar të anulohet vendimi i datës 14.01.2021. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së ushtruar pranë kësaj gjykate, për shkak se organi administrativ për çështje pensionale e ka refuzuar kërkesën time gjëja se nuk i plotësoi kushtet ligjore sipas nenit 8 par. 2 të Ligjit, ndërsa ka qenë e detyruar ta aplikon nenin e njëjtë par. 6 të të njëjtut Ligj, sepse në vitin 1990, jam përjashtuar nga puna nga masat e dhunshme në bazë të veprimeve të saja diskriminuese dhe për këtë konsideroi se Organi Administrativ për çështje të pensioneve nuk e ka shqyrtuar drejtë kërkesën time, sepse unë pasi jam përjashtuar nga puna, jam përfshi në Këshillin Komunal për Arsim, ku aty kam punuar gjatë tërë kohës prej vitit 1991-1999, Këshilli për financim në atë kohë ka qenë infrastrukturë e veprimit për funksionimin e Ministrisë së Arsimit dhe ka qenë pjesë përbërëse e saj, dhe që faktin për financim në asnjë mënyrë as arsimit dhe as sistemi shëndetësor nuk kanë mundur të funksionojnë. *Kërkoj që lënda në bazë të vërejtjeve të gjykatës të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Organi Administrativ.*

E paditura në përgjigje në padi ka kontestuar në tersi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke kërkuar që të refuzohet në tersi si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës.

Në seancën e datës 27.01.2023, palët janë ftuar me rregull, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar e paditura. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurës.

Gjykata në seancën e datës 27.01.20213, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vërtetim i dt.01.10.2018, vërtetim i dt.25.02.1993, aktvendim për pushim vjetor i dt.10.07.1997, vendim i dt.17.09.2999, vendim i dt.06.11.2020, vendim i dt.14.01.2021, ankesë e dt.05.01.2021, diplomë e dt.04.03.1982, kërkesë për lëshimin e vërtetimit ë stazhit të punës, dt.28.09.2018, librezja e Punës Seria 736/81.

Me vendimin kontestues të të paditurës, është refuzuar ankesa e paditësit për njohjen e të drejtës në Pension Kontribut pagues të moshës, me konstatimin mes tjerash se është vërtetuar se nuk janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues konform nenit 8 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka parashtruar padi në gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata kishte parasysh Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, konkretisht nenit 8 të këtij ligji të referuar në vendimin e atakuar i cili përcakton se:

“Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët;

1.1. Kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. Duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) para datës 01.01.1999;

1.3. Ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK NR. 26/83) para datës 01.01.1999”.

Me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet:

“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit,

shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, i njëjti nuk përmban elementet nga neni 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ligj ky i aplikueshëm në periudhën e ankimimit dhe shqyrtimit të çështjes pran organit administrativ. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm *se pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës është vërtetuar se nuk janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pensionim kontribut pagues konform nenit 8 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ngase nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme në kuptim të Ligjit të cekur më lartë për 15 vite stazh kontributiv.* Andaj një arsyetim i tillë fillimisht nuk paraqet asnjë pretendim të paditësit, nuk jepet arsye konkret për pretendimin e paditësit, pra nuk përmendet asnjë provë e shqyrtuar në bazë të së cilës është vërtetuar ndonjë fakt, me cilat prova i ka konstatuar faktet vendimtare dhe mbi cilën bazë ligjore është mbështetur për të ardhur te konstatimi se nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme, në arsyetim referohet dispozita ligjore por nuk arsyeton se pse është e zbatueshme në rastin konkret.

Pavarësisht detyrimit, e paditura as me përgjigje në padi, as në seancën e shqyrtimit kryesor nuk prezanton e ftuar në mënyrë të rregullt dhe as nuk ka ofruar asnjë provë me të cilat do të mbështeste pretendimet e saja.

Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative. Andaj, bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se:

“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.

Ndërsa me nenin 7.3 të këtij ligji, përcaktohet se:

“Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Andaj, në këtë kuptim gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kur as me përgjigje në padi as në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk ka ofruar provat me të cilat ka mbështet vendimin kontestues, dhe si rrjedhojë, paditësit nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet rreth tyre.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe të ketë parasysh provat në shkresat e lëndës. E paditura duhet të ketë në vëmendje në procedurën e rivendosjes po ashtu Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Nr.ref.: AGJ 2113/23 datë 16 janar 2023, konkretisht pikën dy të vendosjes ku konstatohet se *paragrafi 2 i nenit 8 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale te Financuara nga Shteti ne lidhje me nën paragrafin 2.3 te paragrafit 2 te nenit 6 te Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve te Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes se Pagesës se Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë ne përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] te Kushtetutës ne lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) te Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) te Protokollit nr. 12 te Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut, e që Gjykata kishte parasysh se e paditura në vendimin e atakuar referohet në nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale te Financuara nga Shteti.*

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 5,6, 38, 43 dhe 46.2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.786/2021: Data:27.01.2023

Sekretare Juridike
Nazife Sheholli

Gjyqtare
Liridona Ajeti Kajtazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit , në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.